



REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHËRBIM TË QYT.
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 10 Nr. 14060
U. 1 Br. 1

Nr. i faq. 1 Data: 09/06
Datum: 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit
Nr.10/135 datë 09.06/2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe nenit 4 të Statutit të Komunës së Kamenicës, (statuti 01, Nr.20203 datë 21.06.2023), nenit 5 paragrafi 5.1; neni 20 paragrafi 20.2; i Ligjit për rrugët (Ligji Nr.2003/11), si dhe rregullorja për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale në Komunën e Kamenicës, si dhe rrezikut që u shkaktohet këmbësorëve nga lëvizjet e pa kontrolluara të skuterëve elektrik dhe biçikletave në bulevardin e qytetit, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia, nxjerr këtë :

V E N D I M

1. Ndalohet qarkullimi i skuterëve elektrik dhe biçikletave në rrugën "Skënderbeu" deri te aksi që lidhet me rrugën "Vëllezërit Bytyqi", përkatësisht në bulevardin e qytetit;
2. Ndalimi i qarkullimit të skuterëve elektrik dhe biçikletave fillon nga data 10.06.2025, prej orës 19:00 h deri në ora 24:00 h;
3. Në segmentin e rrugës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi të vendoset sinjalizimi përkatës;

A r s y e t i m

Ndalimi i qarkullimit të skuterëve elektrik dhe biçikletave si në pikën 1 të këtij vendimi është marrë për shkak të sigurisë së këmbësorëve ku në këtë periudhë kemi një frekuentim të shtuar të qytetarëve, duke llogaritur edhe ardhjen e qytetarëve tanë nga diaspora, ku kjo pjesë është e dedikuar për lëvizje të lirë të këmbësorëve-shëtitore.

Vlefshmëria e këtij Vendimi është deri më datën **31.08.2025**.

Vendimi t'i dorëzohet:

- DSHPAIE;
- Policisë së Kosovës, stacioni në Kamenicë;
- Zyrës së Informimit;

